



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-045

PËR MINISTRINË PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Dhe me qëllim të rregullimit të përgjegjësisë dhe kompetencave të institucioneve të Republikës së Kosovës në fushën e Sigurisë,

Miraton këtë

LIGJ PËR MINISTRINË PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

Neni 1
Zbatimi i ligjit

Me këtë themelohet Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës do të ketë autoritet ekzekutiv mbi të.

Neni 2
Parimet e përgjithshme

2.1 Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidenti, Kryeministri dhe Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës përbëjnë zinxhirin e mbikëqyrjes civile mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës, siç është përcaktuar me Kushtetutë, me këtë ligj dhe me ligjet tjera përkatëse.

Neni 3

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës

3.1 Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës ka kontroll dhe administrim të përgjithshëm mbi Forcën e Sigurisë të Kosovës, duke përfshirë të gjitha fuqitë që bien mbi Komandantin e Forcës së Sigurisë të Kosovës.

3.2 Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës përfaqëson Republikën e Kosovës në arenën ndërkombëtare lidhur me çështjet e Forcës së Sigurisë së Kosovës në nivel ministror. Ai mund ta delegojë këtë funksion për veprimtari të posaçme.

3.3 Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Zëvendës Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës emërohen nga Kryeministri dhe miratohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

3.4 Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës i përgjigjet Kuvendit të Kosovës përmes Kryeministrit.

3.5 Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Zëvendës Ministri dhe/ose Sekretari i Përhershëm i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dalin para Komisionit përkatës parlamentar për të raportuar mbi çështjet lidhur me Forcën e Sigurisë së Kosovës sa herë që kërkohet nga ta.

3.6 Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, i rekomandon Presidentit kandidatin e përshtatshëm për t'a emëruar Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës.

3.7 Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në konsultim me Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, i rekomandon Presidentit gradimet e të gjithë oficerëve në gradat e gjeneralit.

3.8 Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në konsultim me Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, i rekomandon Presidentit të gjitha ndryshimet në emërime dhe status të oficerëve të rangut të gjeneralit.

3.9 Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës personalisht miraton të gjitha projektet me vlerë më të vogël se 1.000.000 (një milion) Euro. Sekretari i Përhershëm mund të autorizohet që të miratojë projektet me vlerë më të vogël se 500.000 (pesëqind mijë) Euro, kurse udhëheqësi i Departamentit të Prokurimit dhe Kontratave mund të autorizohet që të miratojë projektet me vlerë më të vogël se 200.000 (dyqind mijë) Euro.

3.10 Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës është përgjegjës që:

- a) të propozojë buxhetin e Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe të mbikëqyrë shpenzimet nga buxheti i miratuar;
- b) të përgatisë të gjitha dokumentet e nevojshme politike lidhur me Forcën për Siguri të Kosovës për t'u shqyrtuar nga Këshilli i Kosovës për Siguri;
- c) t'i rekomandojë Kryeministrit madhësinë dhe strukturën e Forcës së Sigurisë të Kosovës brenda buxhetit dhe me një kufi fillestar të përgjithshëm prej 2.500 pjesëtarëve aktivë dhe 800 rezervë, që i nënshtrohet miratimit nga Prania Ndërkombëtare Ushtarake për pesë vitet e para pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;
- d) të përgatisë rregulloret për organizimin e njësive brenda Forcës së Sigurisë të Kosovës në bazë të rekomandimeve të Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës;

- e) të zhvillojë, paraqesë dhe të zbatojë ligjet, politikat dhe rregulloret lidhur me Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forcën e Sigurisë të Kosovës, duke përfshirë edhe fushat e organizimit, administrimit, personelit, të drejtave të njeriut dhe çështjeve të komuniteteve, disiplinës dhe sjelljes, stërvitjes (përfshirë edhe arsimimin akademik), menaxhimit të armëve, pajisjeve dhe angazhimit të Forcës së Sigurisë të Kosovës;
- f) të zhvillojë strategjitë dhe udhëzimet për miratim nga Kuvendi i Kosovës për të zbatuar strategjinë e gjithëmbarshme të sigurisë siç miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- g) të menaxhojë infrastrukturën dhe pajisjet pronë shtetërore, të cilat i janë ndarë Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës për t'u shfrytëzuar nga Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe nga Forca e Sigurisë të Kosovës;
- h) të mbikëqyrë dhe të inspektojë Forcën e Sigurisë të Kosovës;
- i) të organizojë sistemin e komunikimit të Forcës së Sigurisë të Kosovës, përfshirë edhe instalimin e sistemeve të sigurta komunikuese;
- j) të mbikëqyrë të gjitha veprimtaritë e inteligjencës të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të cilat do të kufizohen në mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e atyre informatave që janë thelbësore për mbështetjen e misionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- k) t'i propozojë Qeverisë plane për shfrytëzim të Forcës së Sigurisë të Kosovës në operacione jashtë vendit ose në operacione humanitare në mbështetje të autoriteteve civile;
- l) të sigurojë transparencë dhe efektshmëri në funksionet e saj;
- m) të kryejë kërkime dhe të sigurojë mendime ekspertësh për çështjet lidhur me Forcën e Sigurisë të Kosovës;
- n) të kryejë detyra tjera të përcaktuara me ligj.

3.11 Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës do të punësohen shërbyes civilë, të punësuar tjerë dhe pjesëtarë aktivë të Forcës së Sigurisë të Kosovës të emëruar aty në pajtim me ligjet përkatëse dhe si pjesë e rotacionit të tyre të zakonshëm në detyrë.

3.12 Përqindja e posteve në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës e mbushur nga pjesëtarët aktivë të Forcës së Sigurisë të Kosovës nuk do të tejkalojë 40 për qind të pozitave të autorizuar.

Neni 4

Mbikëqyrja demokratike

4.1 Në pajtim me ligjin, Komisioni përkatës parlamentar i Kuvendit të Republikës së Kosovës ka kompetencë që:

- a) të analizojë të gjitha strategjitë, ligjet dhe dokumentet mbi politikat të dorëzuara nga Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës përmes Qeverisë së Republikës Kosovës, në pajtim me këtë ligj, dhe i përgatitë ato për debat në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- b) të kërkojë praninë e Ministrit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, të Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës në takimet e tyre dhe për t'u përgjigjur pyetjeve;

- c) të shqyrtojë buxhetin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës para dorëzimit në Kuvendin e Kosovës për miratim;
- d) të shqyrtojë të gjitha projektet për pajisje me vlerë më të lartë se 1.000.000 (një milion) Euro të propozuar nga Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, edhe ato që do të financohen nga Qeveria dhe ato që do të financohen nga donatorët para se të dorëzohen në Kuvendin e Kosovës për miratim.

4.2. Dispozitat e nenit 3 dhe nenit 4 të këtij Ligji nuk përbëjnë përjashtim nga rregullat e Prokurimit Publik.

Neni 5

Hyrja në Fuqi

Ky ligj do të hyjë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-045
13 mars 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI